

Menaxhmenti i KRU "Hidromorava"- Sh.A. në Gjilan, i përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv z. Ymer Salihu, duke u bazuar në nenin 13 të Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nr 06/L-081, merr këtë:

V E N D I M

1. **z.Valon Ismajli** emërohet zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike në KRU Hidromorava Sh.A.
2. I emëruari do të ushtroj funksionet e zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike brenda autorizimeve të lejuar në Ligjin për Qasje në dokumente Publike nr.06/L-081.
3. Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumente publike përgatitë raportet e rregullta vjetore, më së largu deri më datën 31 janar të vitit vijues, për vitin paraprak dhe këto raporte ia dërgon Agjencisë për Informim dhe Privatësi, i cili përgatitë raportin gjithëpërfshirës të institucioneve publike për realizimin e të drejtës për qasje në dokumente publike.

A r s y e t i m

Në përputhje me obligimet ligjore të përcaktuara me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, institucionet publike janë të detyruara të caktojnë një zyrtar përgjegjës për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe raportimin e rregullt ndaj Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

KRU "Hidromorava" Sh.A., duke qenë ndërmarrje publike e përkushtuar për të zbatuar parimet e transparencës, llogaridhënies dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve, ka vlerësuar si të domosdoshme caktimin e një personi përgjegjës për këtë fushë. Emërimi i zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente publike siguron një mekanizëm të qartë dhe funksional për pranimin, regjistrimin, shqyrtimin dhe menaxhimin e kërkesave të qytetarëve, si dhe përgatitjen e raporteve të rregullta vjetore në përputhje me ligjin.

Ky hap është i nevojshëm për të garantuar një qasje të barabartë dhe të drejtë të publikut në dokumente, për të përforcuar besimin e qytetarëve në punën e ndërmarrjes dhe për të kontribuar në rritjen e përgjegjësisë institucionale.

Andaj, me qëllim të përmbushjes së kërkesës ligjore u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

K.R.U."Hidromorava" Sh.A.
Kryeshefi Ekzekutiv

Z.Ymer Salihu